



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE TË PASTRIMIT FIER**

Nr. _____ Prot.

Fier, më _____10.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Kontenier (Kosha Per Mbetjet Urbane) Për Nevoja
Te Ndërmarrjes Së Shërbimeve Të Pastrimit,Bashkia Fier” me 2 Lote**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kosha mbetjesh 39224340-3

Kontenier per mbeturinat 44613800-8

VLERA E FONDIT LIMIT/vlera e pritshme e kontratës është : 3 508 500 (tre milion e pesëqind e tetë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh dhe 4 210 200 (kater million e dyqind e dhjetë mijë e dyqind) me tvsh

Loti 1 : “ Blerje kontenier nentokesor (kosha per mbetjet urbane) 3m3 per Ndermarrjen e Sherbimeve te Pastrimit , Bashkia Fier” .

Fondi limit është 1 930 000 (nje million e nenteqind e tridhjetë mijë) leke pa tvsh ose 2 316 000 (dy million e treqind e gjashtembëdhjetë mijë) leke me tvsh (parashikuar ne buxhetin e vitit 2025)

Loti 2: “ Blerje kontenier (kosha per mbetjet urbane) 1.1m3 per Ndermarrjen e Sherbimeve te Pastrimit, Bashkia Fier”

Fondi Limit është 1 578 500 (nje milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) leke pa tvsh ose 1 894 200 (nje milion e teteqind e nentëdhjetë e kater mijë e dyqind) leke me tvsh (parashikuar ne buxhetin e vitit 2025)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja E Sherbimeve te

Pastrimit Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

.....

Loti 1 : “ Blerje kontenier nentokesor (kosha per mbetjet urbane) 3m3 per Ndermarrjen e Sherbimeve te Pastrimit , Bashkia Fier” .

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 9*

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar ne nenin 82 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

b. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit **(2023, 2024)** lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo me pak se **600 000 leke pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet –**Loti 1**). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës.; në pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesipër është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohej në Procedurën e Hapur e thjeshtuar, përkatësisht; Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar; Duke qenë se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara me pare gjykon se është e përshtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat"* i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e dy viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të parashikuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit. Në kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se **300 000 lekë pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet –**Loti 1**), që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese një nga dokumentat e meposhtem:

- a- vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës **ose/dhe** fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

ose

- b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 40, pika 4 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **300 000 lekë pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, piken 4 të nenit 40 dhe piken 4/b të nenit 55 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine teknike te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet pervojes se meparshme, se zoterojne kapacitet dhe aftesine teknike per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim të prodhuesit/distributorit të autorizuar për mallrat objekt prokurimi, shoqëruar me një përshkrim të noterizuar në gjuhën shqipe. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si : telefon, fax,e-mail , website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktore në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim distributor ,operatori ekonomik duhet ta vertetojë duke paraqitur akt

marreveshje/autorizim/kontrate lidhur mes kompanise prodhuese dhe distributorit te autorizuar.

Tabela me zerat e mallrave per te cilat duhet te paraqiten autorizim prodhuesi ose autorizim distributori:

Nr	Emërtimi	Njësia				Destinacioni	Afatet e lëvrimit
			Sasia	Çmimi	Vlera		
1	Kontenier nentokesor 3m3 (1485*1485*1600 cm)	Cope	2			Ndërmarrja e Shërbimeve te Pastrimit	30 (tridhjet) dite nga nënshkrimi i kontrates
2	Kontenier nentokesor 3m3 (1400*1400*1620 cm)	Cope	2			Ndërmarrja e Shërbimeve te Pastrimit	30 (tridhjet) dite nga nënshkrimi i kontrates

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; pika 8, e nenit 40, të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public”, i ndryshuar ku eshte e cituar: 8.Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”, si dhe duke iu referuar per analogji vendimeve te KPP-se dhe rekomandimeve te APP-se, Autoriteti Kontraktor ka gjykuar qe te paraqitet autorizim prodhuesi ose autorizim distributori per mallra objekt prokurimi.

Gjithashtu, Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalën zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim, i garanton gjithashtu AK se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikëpamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve më të larta nga prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës si dhe që do vijojnë për të zbatuar kushtet e garancisë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë per kontenieret objekt i ketij prokurimi te shoqeruara me nje perktim te noterizuar ne gjuhen shqipe, ku te jepen te gjitha karakteristikat teknike te tyre me qellim qe autoriteti kontraktore te verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.

Ne katalogun perkates te jete specifikuar produkti qe eshte paraqitur ne oferte dhe specifikimet teknike.

Ne katalog duhet te pasqyrohen specifikimet teknike (vellimi,pasha,gjatesia,gjeresia,lartesia) e trupit te kontenierit dhe kapakut.

Tabela me zerat e mallrave per te cilat duhet te paraqiten katalogë:

Nr	Emërtimi	Njësia				Destinacioni	Afatet e lëvrimit
			Sasia	Çmimi	Vlera		
1	Kontenier nentokesor 3m3 (1485*1485*1600 cm)	Cope	2			Ndërmarrja e Shërbimeve te Pastrimit	30 (tridhjet) dite nga nënshkrimi i kontrates
2	Kontenier nentokesor 3m3 (1400*1400*1620 cm)	Cope	2			Ndërmarrja e Shërbimeve te Pastrimit	30 (tridhjet) dite nga nënshkrimi i kontrates

Tabela me zerat e mallrave per te cilat duhet te paraqiten katalogë:

Argumentimi: Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht: Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

Paraqitja e katalogjeve per zerat e mallrave, eshte kerkuar me qellim verifikimin e perputhshmerise se mallrave qe operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike te percaktuara ne DST.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë per garanci 12- mujore per mallin objekt kontrate.

Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje deklaratë me ane te se ciles te deklaroje se merr persiper transportin e konteniereve.

Argumentimi: Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 5 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se malli i ofruar (në rastin konkret gomat) është cilësor dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në cdo rast operatori ekonomik gjatë

periudhës së garancisë duhet të mbajë përgjegjësi për mallat që ofron dhe se do t'i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar dëmtohet gjatë përdorimit për shkak të difekteve që vijnë si rrjedhojë e prodhimit të tyre.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar dhe argumentuar nga grupi i punës derguar me shkresën nr.300/4 prot date 10.04.2025, si dhe në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “*Per Prokurimin Publik*”, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar. Kriteret teknike të veçanta të kualifikimit lidhur me kapacitetin teknik janë hartuar e argumentuar nga grupi i punës.

Loti 2: “ Blerje kontener (kosha për mbetjet urbane) 1.1m3 për Ndermarrjen e Sherbimeve të Pastrimit, Bashkia Fier”

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 9

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 82 të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “*1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*”

b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2023, 2024**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo me pak se **600 000 leke pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet –**Loti 2**). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 3 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës.; në piken 1 dhe piken 2/c të nenit 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vite të fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesipër është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/c të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur e thjeshtuar, përkatesisht; Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar; Duke qenë se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë gjykon se është e përshtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 *”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”* i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat”* i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar te nevojshme përcaktimin e dy viteve te fundit ne perputhje me vleren e fondit limit te parashikuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit. Ne kete rast vlere e kerkuar eshte jo me pak se **300 000 lekë pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet – **Loti 2**), që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese një nga dokumentat e meposhtem:

- c- vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlere, afati i përfundimit të kontratës **ose/dhe** fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

ose

- d- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, te plotësuar sipas kërkesave te legjislacionit ne fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, nenit 40, pika 4 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”* i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo me pak se **300 000 lekë pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, piken 4 te nenit 40 dhe piken 4/b te nenit 55 të VKM nr.285 date 19.05.2021 *“Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”* i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të

ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet përvojës së mëparshme, se zotërojnë kapacitet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim të prodhuesit/distributorit të autorizuar për mallrat objekt prokurimi, shoqëruar me një përshkrim të noterizuar në gjuhën shqipe. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si : telefon, fax, e-mail , website, kjo është e nevojshme për autoritetin kontraktues në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim distributor ,operatori ekonomik duhet ta vërtetojë duke paraqitur akt marrëveshje/autorizim/kontratë lidhur me kompaninë prodhuese dhe distributorit të autorizuar.

Tabela me zerat e mallrave për të cilat duhet të paraqiten autorizim prodhuesi ose autorizim distributor:

Nr	Emërtimi	Njësia				Destinacioni	Afatet e lëvrimit
			Sasia	Çmimi	Vlera		
1	Kontener (kosha për mbetjet urbane) 1.1 m3	Cope	35			Ndërmarrja e Shërbimeve të Pastrimit	30 (tridhjet) ditë nga nënshkrimi i kontratës

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; pika 8, e nenit 40, të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku është e cituar: 8.Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”, si dhe duke iu referuar për analogji vendimeve të KPP-se dhe rekomandimeve të APP-se, Autoriteti Kontraktor ka gjykuar që të paraqitet autorizim prodhuesi ose autorizim distributor për mallra objekt prokurimi.

Gjithashtu, Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalën zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim, i garanton gjithashtu AK se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikëpamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve më të larta nga prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e

produkteve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës si dhe që do vijojnë për të zbatuar kushtet e garancisë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë për kontenieret objekt I këtij prokurimi të shoqëruara me një përshkrim të noterizuar në gjuhën shqipe, ku të jepen të gjitha karakteristikat teknike të tyre me qëllim që autoriteti kontraktore të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.

Në katalogun përkatës të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike.

Në katalog duhet të pasqyrohen specifikimet teknike (vëllimi, pasha, gjatësia, gjerësia, lartësia) e trupit të kontenierit dhe kapakut.

Tabela me zerat e mallrave për të cilat duhet të paraqiten katalogë:

Nr	Emërtimi	Njësia				Destinacioni	Afatet e lëvrimit
			Sasia	Çmimi	Vlera		
1	Kontenier (kosha për mbetjet urbane) 1.1 m ³	Cope	35			Ndërmarrja e Shërbimeve të Pastrimit	30 (tridhjet) dite nga nënshkrimi i kontratës

Tabela me zerat e mallrave për të cilat duhet të paraqiten katalogë:

Argumentimi: Vendorsja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht: Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

Paraqitja e katalogjeve për zerat e mallrave, është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së mallrave që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë për garanci 12- mujore për mallin objekt kontrate.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së ciles të deklarojë se merr përsipër transportin e konteniereve.

Argumentimi: Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të

ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se malli i ofruar (në rastin konkret gomat) është cilësor dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në cdo rast operatori ekonomik gjatë periudhës së garancisë duhet të mbajë përgjegjësi për mallat që ofron dhe se do t'i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar dëmtohet gjatë përdorimit për shkak të defekteve që vijnë si rrjedhojë e prodhimit të tyre.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar dhe argumentuar nga grupi i punës derguar me shkresën nr.300/4 prot date 10.04.2025, si dhe në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “*Per Prokurimin Publik*”, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar. Kriteret teknike të vecanta të kualifikimit lidhur me kapacitetin teknik janë hartuar e argumentuar nga grupi i punës.

Bashkalidhur DST në SPE.

Specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo reference të ndonjë marke apo emri të vecantë, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik, përveç kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme e saktë ose e kuptueshme e përshkrimit të kërkesave me kusht që fjala “ose ekuivalent” përfshihet detyrimisht në këto specifikime.

Shenim: *Në cdo rast kur në specifikimet teknike dhe preventive mund të jete përdorur si reference emri i ndonjë marke apo emri të vecantë, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik, përfshihet dhe fjala “ose ekuivalent” i saj.*

Njësia e Prokurimit:
